



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 285/6 prot.

Tiranë, më 15.7.2021

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 393, datë 3.6.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Gerd Hoxha
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese;

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 1.7.2021, është njoftuar vendimi nr. 393, datë 3.6.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Gerd Hoxha, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ndaj këtij vendimi, bazuar në nenin B, pika 3, germa “c”, të aneksit të Kushtetutës dhe nenin 65, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 8.7.2021, është depozituar akti “Rekomandim për paraqitje ankimi”, nënshkruar nga një komision prej tre vëzhguesish ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (në vijim referuar ONM).

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, unë, Komisioneri Publik Darjel Sina, ushtroj ankim ndaj vendimit nr. 393, datë 3.6.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

## I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Gerd Hoxha, prej vitit 2003 ushtron detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe, në zbatim të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për subjektin z. Gerd Hoxha ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kriterëve, atë të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni), ka administruar raportet e vlerësimit për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit (në vijim referuar si DSIK) dhe raportin e vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim referuar si KLGJ), nga të cilat rezulton se:

2.1 ILDKPKI-ja, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin Gerd Hoxha”, ka referuar për subjektin, se:

- i. Deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin;
- ii. Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- iii. Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- iv. Nuk ka kryer deklaram të rremë;
- v. Nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2 DSIK-ja, bazuar në nenin 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, i ka referuar Komisionit: “Përshatshmërinë për vazhdimin e detyrës”.

2.3 KLGJ-ja, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për kontrollin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Hoxha, ka hartuar një raport të hollësishëm, të cilin ia ka përcjellë Komisionit.

3. Përfundimet e Komisionit për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

3.1 **Për vlerësimin e pasurisë.** Referuar nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi ka hetuar dhe vlerësuar gjendjen pasurore të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, saktësinë dhe mjaftueshmërinë e deklarimeve periodike të interesave pasurore krahasuar me atë “Vetting”, ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, të ardhurat, shpenzimet dhe pagimin e detyrimeve financiare, ka arritur në përfundimin se: [...] (i) pavarësisht mospërputhjes të konstatuar midis deklaratës noteriale të bashkëshortëve \*\*\* me deklaramet e ish-bashkëshortes së subjektit në DPV/2004, në vështrim të aneksit D, pika 5, të Kushtetutës, mospërputhjet në deklarime nuk mund të përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore apo të sjellin pasoja për subjektet, për sa kohë ato nuk janë përpjekur të fshehin apo të deklarojnë në mënyrë të pasaktë pasurinë; (ii) balanca negative e fondeve në vitin 2006 prej – 95.792 lekësh dhe në vitin 2011 në shumën -10.604 lekësh, janë në një vlerë të papërfillshme për të sjellë si pasojë zbatimin e nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016; (iii) pavarësisht faktit nëse prindërit e ish-bashkëshortes kanë pasur ose jo të ardhura për dhënien e huas në shumën 25.000 euro, nuk mund të shërbejë si shkak për marrjen e masës

disiplinore ndaj subjektit, për sa kohë kemi të bëjmë me një detyrim të lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me ish-bashkëshorten e tij, të lindur para martesës me të, si dhe aktualisht ky detyrim nuk i përket subjektit, por ish-bashkëshortes së tij, që është subjekt rivlerësimi më vete. Duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, deklaramet e pasakta të konstatuara apo mungesa financiare si më sipër nuk duhet të ndikojnë në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit. Komisioni çmon se, për shkak të peshës specifike të vogël të tyre dhe mungesës së pasojave, ato nuk cenojnë figurën e gjyqtarit, dhe as besimin e publikut te drejtësia. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Gerd Hoxha, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016<sup>1</sup> [...].

**4. Për kontrollin e figurës.** Referuar nenit DH, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në konsideratë të verifikimit dhe të konfirmimit nga institucionet përgjegjëse për përshtatshmërinë, edhe pas kryerjes së hetimit të thelluar, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Gerd Hoxha, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës dhe është në kushtet e përshtatshme për vazhdimin e detyrës.

**5. Për vlerësimin e aftësive profesionale.** Referuar nenit E, të aneksit të Kushtetutës, nenit 43/2 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016, si dhe kreut II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, të ndryshuar, Komisioni, pasi ka administruar dhe analizuar: (i) raportin e përgatitur nga KLGJ-ja, (ii) mendimin e datës 11 nëntor 2019 dhe dy gjetje, datë 13 dhe 20 janar 2020, paraqitur nga ana e një vëzhguesi ndërkombëtar të ONM-së, (iii) denoncimet nga publiku, (iv) shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën, si dhe (v) rekomandimin nga ana e relatorit të çështjes, ka arritur në përfundimin se: [...] *nuk mund të ngrihen dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e gjyqtarit. Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe konsiderohet i “aftë” në aspektin profesional... Në lidhje me dy gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar, Komisioni, referuar vendimit nr. 2/2017, të Gjykatës Kushtetuese, sipas të cilit: “Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale”, çmon se këto gjetje nuk përbëjnë shkak për ta konsideruar të papërshtatshëm subjektin për të ushtruar funksionin e tij si magjistrat, por që, në zbatim të pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, këto dy gjetje duhet të përcillen pranë organit kompetent për inspektimin e shkeljeve të mundshme disiplinore<sup>2</sup> [...].*

**6. Vendimi i Komisionit.** Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli, trupi gjykues i Komisionit, bazuar në nenin 58, pika 1, germa “a” dhe nenin 59, pikat 1 dhe 4, të ligjit nr. 84/2016, me shumicë votash, ka vendosur (ndër të tjera, si pjesë e dispozitivit):

- Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Gerd Hoxha, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë;

<sup>1</sup> Për më tepër referohuni në f. 43-44, të vendimit.

<sup>2</sup> Për më tepër, referohuni në f. 65, të vendimit.

- Në zbatim të pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, transferimin e gjetjes nr. 48 prot., datë 13.1.2020, të vëzhguesit ndërkombëtar dhe gjetjes nr. 94 prot., datë 20.1.2020, të vëzhguesit ndërkombëtar, pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për inspektimin e shkeljeve të mundshme disiplinore.

## II. Rekomandimi i Operacionit Ndërkombëtar i Monitorimit (ONM)

7. Bazuar në nenin B, pika 3, germa “c<sup>3</sup>”, të aneksit të Kushtetutës dhe nenin 65/2<sup>4</sup>, të ligjit nr. 84/2016, një komision i përbërë nga tre përfaqësues të ONM-së, më datë 8.7.2021, kanë paraqitur pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, “Rekomandim për paraqitje ankimi” ndaj vendimit nr. 393, datë 3.6.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit z. Gerd Hoxha (bashkëlidhur këtij ankimi).

7.1 Në mënyrë të përmbledhur, objekti i këtij rekomandimi është nevoja për hetimin e mëtejshëm dhe rivlerësimin e *kriterit të pasurisë* lidhur me çështjet: (i) kontrollin e burimit të ligjshëm të krijimit të pasurisë *apartment me sip. 125 m<sup>2</sup> në Tiranë*; (ii) *huan prej 25.000 euro*, marrë nga \*\*\* Bank, e shlyer po me hua në shumën 25.000 euro, deklaruar si e marrë nga ish-bashkëshortja prej prindërve të saj; (iii) kontrollin e burimit të ligjshëm të krijimit të pasurisë *apartment me sip. 128 m<sup>2</sup> në Vlorë*; dhe (iv) përdorimin/pronësinë e automjetit “Audi Q7”. Pjesë e rekomandimit është nevoja edhe për rivlerësimin e *kriterit profesional* (veçanërisht lidhur me mendimin dhe dy gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar të ONM-së), proces i cili do të siguronte që ai (subjekti), me të vërtetë, të ketë besimin e publikut, rivendosja e të cilit është qëllimi kryesor i procesit të rivlerësimit dhe i institucioneve që e zbatojnë atë.

## III. Mendimi dhe dy gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar të ONM-së, të paraqitura gjatë hetimit administrativ të Komisionit

8. Bazuar në nenin B, pika 3, germa “b<sup>5</sup>”, e aneksit të Kushtetutës dhe nenin 49, pikat 10 dhe 11 të ligjit nr. 84/2016, rezulton se, gjatë hetimit administrativ, që i përket subjektit të rivlerësimit z. Gerd Hoxha, Komisioni ka administruar *një mendim*, të datës 11.11.2019, dhe *dy gjetje*, të datës 13 dhe 20 janar 2020, të dhëna nga vëzhguesi ndërkombëtar i ONM-së, lidhur me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

## IV. Vlerësimi i Komisionerit Publik

9. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting).

10. Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisionerit Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

<sup>3</sup> Vëzhguesi ndërkombëtar ushtron këto detyra ... u jep Komisionerëve Publikë rekomandime me shkrim për të paraqitur ankim. Në rast se Komisioneri Publik nuk i zbaton rekomandimet, ai përgatit një raport me shkrim, duke dhënë arsyet e refuzimit.

<sup>4</sup> Vëzhguesi ndërkombëtar ka të drejtë t'i paraqesë rekomandim me shkrim Komisionerit Publik për të paraqitur ankim. Ky rekomandim jepet nga një komision i përbërë nga të paktën 3 përfaqësues të ONM-së.

<sup>5</sup> Vëzhguesi ndërkombëtar ushtron këto detyra: ... “Paraqet gjetje dhe mendime mbi çështje që shqyrtohen nga Komisioni dhe nga Kolegji i Apelit, si dhe kontribuon ...”.

- 11.** Në krahasim me kompetencat e njohura për Komisionin dhe Kolegjin, nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni.
- 12.** Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave të administruara.
- 13.** Edhe në rastin konkret, Komisioneri Publik, mbështetur në kompetencën e tij kushtetuese dhe ligjore, në konsideratë edhe të rekomandimit të ONM-së, konstaton se nga shqyrtimi i vendimit nr. 393/2021 të Komisionit dhe akteve shoqëruese të tij, paraqiten rrethana të tilla ligjore e fakti, për të cilat çmon se ky vendim është i cenusshëm në tërësinë e tij, si dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t'iu paraqitur juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit.
- 14.** Sa më sipër, referuar dhe përmbajtjes së rekomandimit të paraqitur nga një komision prej tre vëzhguesish ndërkombëtarë të ONM-së, Komisioneri Publik çmon se procesi i hetimit, i kryer nga Komisioni për kriterin e vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit z. Gerd Hoxha, nuk ka qenë i plotë, e për rrjedhojë, përfundimet e arritura nuk janë në pajtueshmëri me provat e administruara.
- 15.** Komisioneri Publik, nëpërmjet këtij mjeti procedural (ankimit), në respektim të kërkesave kushtetuese e ligjore për rivlerësimin kalimtar të subjekteve dhe në mbrojtje të interesit publik, synon kontrollin e vendimit nr. 393/2021, të Komisionit nga ana e Kolegjit, lidhur me nevojën e hetimit të mëtejshëm të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe interesat private të tij, të personave të lidhur, të personave të tjerë të lidhur me të, si dhe kryerjen e një analize të re financiare, me qëllim justifikimin bindshëm të burimit të ligjshëm të krijimit të pasurive, me të ardhura të ligjshme, sipas urdhërimit të nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.
- 16.** Komisioneri Publik, në vijimësi të qëndrimeve të mbajtura nga ky institucion në ushtrimin e ankimeve, nëpërmjet të cilave kërkohet hetimi i mëtejshëm i kriterëve të rivlerësimit, referuar përmbajtjes së pikës 2, të nenit 4, pikës 1, të nenit 59 dhe pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, çmon se edhe kontrolli i dy kriterëve të tjera të procesit të rivlerësimit, ai profesional dhe i figurës, bazuar në nenin E dhe nenin DH, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, duhet t'i nënshtrohet hetimit dhe vlerësimit nga ana e Kolegjit, për të arritur eventualisht në një vendimmarrje për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, në një vlerësim të përgjithshëm të të tria kriterëve të rivlerësimit.
- 17.** Në të tilla rrethana, Komisioneri Publik konstaton se procesi i hetimit i kryer nga Komisioni, për të tria kriteret e rivlerësimit, ka mangësi dhe, për rrjedhojë, në gjendjen që janë aktet, nuk mund të konkludohet se subjekti i rivlerësimit është në kushtet e parashikuara nga neni 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

18. Komisioneri Publik vlerëson se, nëpërmjet këtij ankimi, do të bëhet e mundur që këto mangësi të vërejtura gjatë hetimit administrativ, nga ana e Komisionit, të mund të riparohen gjatë shqyrtimit të ankimit nga ana e Kolegjit.

19. Bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 4 dhe 66 të ligjit nr. 84/2016, ky ankim i Komisionerit Publik, ndaj vendimit nr. 393, datë 3.6.2021, të Komisionit, ushtrohet për të tria kriteret e rivlerësimit.

## V. Analiza e shkaqeve të ankimit

### V.A. Për kontrollin e pasurisë

20. Për sa i takon rivlerësimit të kriterit të pasurisë, referuar nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik mban në konsideratë se gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi sipas nenit 179/b të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklaramëve të subjektit (“Vetting” dhe ato periodike), ku në çdo rast subjekti i rivlerësimit duhet të deklarojë tërësinë e pasurisë së tij dhe shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj, si dhe ekzistencën e të ardhurave të ligjshme, sipas përkufizimit kushtetues.

21. Nga aktet e administruara dhe përmbajtja e vendimit të Komisionit, rezulton se gjatë hetimit administrativ të kriterit të pasurisë, subjektit të rivlerësimit i janë kërkuar shpjegime dhe i është kaluar barra e provës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, pasi janë konstatuar problematika mbi saktësinë, mjaftueshmërinë dhe ligjshmërinë e burimit të ligjshëm të krijimit të pasurive, të subjektit të rivlerësimit, personave të lidhur dhe të tjerë të lidhur me të.

22. Interesat private dhe pasurore, të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, janë deklaruar fillimisht në “*Deklaratën e personit, që mbart detyrimin për deklarim pasurie*”, dorëzuar në ILDKPKI, më datë 19.3.2004, dhe në vijim në deklaratat periodike për vitet 2004 - 2016 (këtu e në vijim referuar si DV-20...), dhe në Deklaratën “Vetting” (këtu e në vijim referuar si D-Vett.), dorëzuar në ILDKPKI, në datën 25.1.2017. Nga shqyrtimi dhe krahasimi i deklaratave si më sipër, referuar nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në funksion të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, pasuritë e deklaruara rezultojnë:

23. **Pasuria nr. 1, “Apartament me sip. 125 m<sup>2</sup>”, ndodhur në rrugën “\*\*\*\* \*\*\*\*”, Tiranë (në vijim referuar si “Apartament me sip. 125 m<sup>2</sup> Tiranë”).**

23.1 Në D-Vett., deklarohet: *Apartament banimi me sip. 125 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*\*/\*\*\*\*+\*\*\*\*-\*\*\*\*, zk. \*\*\*\*, vol. \*\*\*\*, fq. \*\*\*\*, kt. \*\*\*\*, ap.\*\*\*\*, ndodhur në rr. “\*\*\*\* \*\*\*\*”, Tiranë. Vlera: 6.500.000 lekë, në bashkëpronësi me znj. \*\*\*\* \*\*\*\*. Çmimi i blerjes është më i ulët se çmimi i tregut, për shkak të marrëdhënies së posaçme mes znj. \*\*\*\* \*\*\*\* dhe znj. \*\*\*\*. \*\*\*\*. dhe z. \*\*\*\*. \*\*\*\*. Pjesa takuese: 50%. Burimi i krijimit: Shuma prej 6.500.000 lekë është siguruar nga: (i) 5.000.000 lekë, kredi pranë Bankës \*\*\*\*, sipas VKM-së nr. 600, datë 12.9.2007; (ii) diferenca prej 1.500.000 lekë është siguruar nga kursimet personale ndër vite; (iii) pjesa prej 50% e znj. \*\*\*\* \*\*\*\*është përfutur me dhurim, për shkak të marrëdhënies së posaçme me palën shitëse.*

23.2 Në DV-2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasurinë saktësisht si më sipër, duke specifikuar mbi burimin e deklaruar: “dhurim të pjesës 50%, në emër të \*\*\*\* \*\*\*\*”, se: *Dhurimi*

do të pasqyrohet në kontratën përfundimtare të shitjes, e cila do të hartohet në një datë të mëvonshme.

23.3 Në DV-2012, subjekti ka deklaruar: *Blerje apartamenti me të dhënat si më sipër, sipas kontratës së shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*\*.10.2012, me vlerë 6.500.000 lekë, në bashkëpronësi me znj. \*\*\* \*\*\*. Gjithashtu deklarom se pjesa prej 50 % është përfituar prej znj. \*\*\* \*\*\*me dhurim, për shkak të marrëdhënies së posaçme me palën shitëse. Për pasojë, vlera e apartamentit është më e ulët se çmimi i tregut.*

23.4 Nga dokumentacioni i përcjellë nga ASHK Tiranë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.3.2019, dhe nga aktet e administruara në dosjen e ILDKPKI-së, rezulton se origjina e kësaj pasurie rrjedh nga “kontrata premtim shitje” nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*\*.2.2011, dhe kontrata e shitjes nr. \*\*\* rep., \*\*\* kol., datë \*\*\*.10.2012, hartuar pranë noteres \*\*\* \*\*\* dhe lidhur midis palëve: \*\*\* dhe \*\*\* \*\*\*, në cilësinë e palës shitëse dhe \*\*\* \*\*\*dhe \*\*\* \*\*\*, në cilësinë e palës blerëse.

23.5 Në nenin 3 të “kontratës premtim shitje” nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*\*.2.2011, përcaktohet se vlera e përgjithshme e objektit të kësaj kontrate është 6.500.000 lekë. Kjo vlerë është më e ulët se çmimi i tregut, për shkak të marrëdhënieve të ngushta gjinore midis palëve kontraktore. Ndërsa në nenin 4, lidhur me mënyrën e pagesës, përcaktohet se vlera shlyhet me dy këste: (i) kësti i parë, në shumën 1.500.000 lekë, është likuiduar jashtë zyrës noteriale në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate; (ii) kësti i dytë, prej 5.000.000 lekë, do të kalojë në favor të palës shitëse, në momentin e lëvrimin të kredisë nga \*\*\* te blerësi Gerd Hoxha.

23.6 Nga hetimi administrativ i Komisionit, lidhur me ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë: *Apartament me sip. 125 m<sup>2</sup>, Tiranë*, ka rezultuar si vijon:

**24. Mbi burimin e pagesës së kështit të parë, në shumën 1.500.000 lekë**

24.1 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, i pyetur nga Komisioni mbi burimin e shumës prej 1.500.000 lekë, të deklaruar në D-Vett., si burim për pagesën e kështit të parë për blerjen e kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se shuma përbëhet nga: (i) të ardhurat e siguruar nga paga për periudhën 1995-2000 në sektorin privat<sup>6</sup>; (ii) të ardhurat nga shkolla e magjistraturës për periudhën 2000-2002; (iii) të ardhurat nga paga si gjyqtar për periudhën tetor 2002 - dhjetor 2011; si dhe (iv) të ardhura të tjera të siguruar nga shpërblime si ekspert, pagesa si lektor etj., për periudhën deri në blerjen e pasurisë.

24.2 Komisionit i ka rezultuar se në DV-2003, subjekti deklarom gjendje *cash* në shumën 2.500.000 lekë me burim nga Shkolla e Magjistraturës dhe sektori privat. Në lidhje me këto kursime, në shpjegimet e dhëna pranë ILDKPKI-së, të datës 20.1.2015, subjekti ka deklaruar se: *“Shuma prej 2.500.000 lekë, e deklaruar në deklarimin fillestar të vitit 2003, disponohej tërësisht në formë cash, në banesën e tij dhe është krijuar nga kursimet e tij nga: paga si student i Shkollës së Magjistraturës (përfshi edhe vitin III të stazhit si gjyqtar) e kursyer e gjitha, plus të ardhurat e kursyera nga punësimi gjatë 5 viteve të shkollës së lartë, në sektorin privat (bare, restorante, lojëra fati, lotari, këmbim valutor etj.). Gjatë kësaj kohe, të gjitha shpenzimet e tij përballoheshin nga prindërit, me të cilët banonte”*.

<sup>6</sup> Subjekti në përgjigje të pyetësorit ka listuar dhe subjektet tregtare në të cilat ka qenë i punësuar gjatë kësaj periudhe.

24.3 Për të provuar ligjshmërinë e shumës 1.500.000 lekë, subjekti gjatë hetimit administrativ ka depozituar deklarata noteriale të hartuara gjatë hetimit administrativ,<sup>7</sup> si dhe shkresa kthim përgjigje nga organet përgjegjëse<sup>8</sup>.

24.4 Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, për shumën e mësipërme, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, për të provuar:

- *Pagesën e detyrimeve tatimore në lidhje me këtë shumë.*
- *Përfitim të kësaj shume nga ana e tij për shkak të punësimit.*

24.5 Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e tij të datës 21.5.2021, ka deklaruar se, në përgjigjet e pyetësorit të datës 5.2.2021, ka dhënë shpjegime në lidhje me kërkesën e KPK-së për të vendosur në dispozicion dokumentacion provues për burimin e ligjshëm të të ardhurave, në shumën 2.500.000 lekë, të deklaruara si kursime *cash* në vitin 2003 (duke listuar edhe një herë të ardhurat e fituara për periudhën 1995-2000, nga sektori privat dhe të ardhurat e periudhës 2000-2003, nga Shkolla e Magjistraturës dhe si gjyqtar), si dhe ka listuar përgjigjet e marra nga institucionet përgjegjëse (ISSH dhe tatime)<sup>9</sup> sipas kërkesave të tij. Për sa më sipër, subjekti, në shpjegimet e tij, ka pretenduar se gjendet në kushtet e parashikuara në paragrafin 2<sup>10</sup>, të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016.

24.6 Komisioni, për sa më sipër, arsyeton se: [...] *Subjekti ka bërë të gjitha përpjekjet për të siguruar informacionin e kërkuar ... Subjekti është në pamundësi reale për të provuar pagesën e tatimit në burim për këto të ardhura, duke qenë se nuk ka qenë detyrim i tij për ta paguar, si dhe nuk ka qenë në detyrë për t'u treguar i kujdesshëm në kontrollin dhe ruajtjen e informacionit. Komisioni vlerëson se mungesa e të dhënave në institucionet që kanë detyrimin ligjor në përpunimin dhe ruajtjen e këtyre të dhënave, nuk mund të penalizojë subjektin pas 20 vjetësh, duke pasur në konsideratë këtu pikën 2, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim, trupi gjyqës vlerëson të marrë në konsideratë dhe të përfshijë në analizën financiare shumën e deklaruar nga subjekti, si të përfitur nga puna e tij me kohë të pjesshme, në sektorin privat, për periudhën 1995-2000, prej 1.500.000 lekë (duke konsideruar si kursim shumën 1.273.804 lekë)<sup>11</sup> [...].*

<sup>7</sup> Deklaratë noteriale nr. \*\*\*/\*\*, dt. \*\*\*/7.2018, lëshuar nga znj. \*\*\* \*\*\*; Deklaratë noteriale nr. \*\*\*/\*\*, dt. \*\*\*/7.2018, lëshuar nga z. \*\*\* \*\*\*. Deklaratë noteriale nr. \*\*\*/\*\*, dt. \*\*\*/8.2020, lëshuar nga z. \*\*\* \*\*\*.

<sup>8</sup> Vërtetim nr. \*\*\* prot., dt. \*\*\* 6.2020, e Degës Rajonale të Arkivit të ISSH-së Tiranë; Vërtetim nr. \*\*\* prot., dt. \*\*\* 6.2020, i Degës Rajonale të Arkivit të ISSH-së Tiranë; Kthim përgjigje nr. \*\*\*/\*\* prot., datë \*\*\*.2.2021, ISSH, Drejtoria Rajonale Tiranë; Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.2.2021, e Degës së Arkivit të Rajonit Tiranë, ku vërtetohet se për subjektin "\*\*\*\*" sh.p.k., për periudhën tetor 1995 - tetor 1997, me administrator \*\*\* \*\*\*, nuk disponohet asnjë lloj dokumentacioni; Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.2.2021, i Degës së Arkivit të Rajonit Tiranë, ku vërtetohet se është kontrolluar dosja nr. \*\*\* me NIPT \*\*\* dhe rezulton që emri i subjektit nuk figuron; Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.2.2021, i Degës së Arkivit të Rajonit Tiranë për subjektin Bar Kafe "\*\*\*\*", për periudhën janar 1999 - maj 2000, u kontrollua dosja nr. \*\*\* me NIPT \*\*\* dhe rezulton që për periudhën e kërkuar nuk ka listëpagesa deri tani.

<sup>9</sup> Në lidhje me shumën e mbetur prej 1.273.804 lekë, pasi nga aktet e depozituara rezulton se për periudhën 2000-2003, të ardhurat nga Shkolla e Magjistraturës dhe puna si gjyqtar janë në shumën 1.226.026 lekë.

<sup>10</sup> Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t'i vërtetohet institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkak të arsyeshme. Ky rregull zbatohet edhe në ato raste kur organi përgjegjës për lëshimin e dokumenteve justifikuese nuk përgjigjet brenda afatit ligjor.

<sup>11</sup> Për më tepër, referohuni f. 12-13, të vendimit.



**25.** Mbi burimin e pagesës së këstit të dytë, në shumën 5.000.000 lekë

25.1 Nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, ka rezultuar se kësti i dytë, në shumën 5.000.000 lekë, është paguar nëpërmjet kredisë së disbursuar në datën \*\*\*.6.2011, z. Gerd Hoxha, nga \*\*\*, në shumën 4.950.000 lekë, përfituar prej tij bazuar në VKM-në nr. 600, datë 12.9.2007, “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe funksionarëve politikë”. Nga nxjerrja e llogarisë në lekë të subjektit pranë \*\*\*, rezulton se, në datën \*\*\*.6.2011, është transferuar shuma 4.900.000 lekë në llogari të \*\*\*, \*\*\*.

**26.** Për pasurinë *Apartament me sip. 125 m<sup>2</sup>, Tiranë*, gjatë hetimit administrativ, rezulton se janë deklaruar edhe shpenzime rikonstruksioni dhe mobilimi, në shumën 25.000 euro, me burim kredi nga \*\*\* Bank, marrë nga shtetasja \*\*\* \*(ish-bashkëshortja e subjektit). Referuar deklaratave periodike vjetore, kjo kredi, por jo qëllimi, rezulton e deklaruar si më poshtë:

26.1 Në DV-2009, në rubrikën: “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti i rivlerësimit deklaroi cilësinë e tij si dorëzanës në kredinë e marrë nga znj. \*\*\* \*, pranë \*\*\* Bank, datë \*\*\*.4.2009, në shumën 25.000 euro.

26.2 Në DV-2010, subjekti i rivlerësimit deklaroi të njëjtën marrëdhënie si më sipër.

26.3 Në DV-2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Statusi si dorëzanës në kredinë bankare të marrë nga znj. \*\*\* \* ka përfunduar për shkak të shlyerjes së kredisë nga znj. \*\*\* më dt. \*\*\*.2.2011.*

26.4 Në D-Vett., subjekti ka deklaruar në rubrikën: “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, si vijon: *hua pa interes dhe pa afat, shuma 25.000 euro, marrë në vitin 2011 prej bashkëshortes sime nga prindërit e saj, shumë e cila shërbeu për shlyerjen e kredisë së marrë në dt. \*\*\*.4.2009, pranë \*\*\* Bank, kredi e shlyer tërësisht në dt. \*\*\*.2.2011*. Shuma e detyrimit financiar, në momentin e plotësimit të Deklaratës “Vetting”, deklarohet 25.000 euro.

26.5 Nga korrespondenca me \*\*\* Bank (ish-\*\*\* Bank)<sup>12</sup>, ka rezultuar se kjo kredi është shlyer tërësisht në datën \*\*\*.2.2011, nëpërmjet depozitimit *cash* të shumës 24.500 euro, nga shtetasja \*\*\* \* (e motra e ish-bashkëshortes së subjektit).

**27.** Mbi huan 25.000 euro, deklaruar nga subjekti, e marrë nga znj. \*\*\* \* prej prindërve të saj

27.1 Në përgjigje të pyetësorit të datës 6.8.2020, subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë hua ka deklaruar: *Bazuar në kontratën e huas dt. \*\*\*.4.2009, shuma prej 25 000 euro është marrë hua vetëm nga ish-bashkëshortja e tij, nga “\*\*\* \*” Tiranë, me qëllim rikonstruksionin dhe arredimin e apartamentit në rr. “\*\*\* \*”, Tiranë, i cili u ble më pas nga ai dhe ish-bashkëshortja. Në këtë kontratë ai ka qenë në cilësinë e dorëzanësit.*

27.2 Në shpjegimet e dhëna pranë ILDKPKI-së të datës 20.1.2015, subjekti i rivlerësimit dhe ish-bashkëshortja e tij kanë deklaruar: *“Kredia prej 25.000 euro, e marrë nga znj. \*\*\* \* tek \*\*\* Bank, ku ai ka qenë dorëzanës, është marrë për të rikonstruktuar dhe arreduar apartamentin... Gjatë periudhës së arredimit dhe rikonstruktimit, ata nuk banonin në këtë apartament. Ai banonte te prindërit e tij dhe znj. \*\*\* \* te prindërit e saj. Shuma prej 25.000*

<sup>12</sup> Referohuni shkresës nr. prot. \*\*\*, datë \*\*\*.2.2019.

euro, që i është **dhuruar** znj. \*\*\* nga babai i saj, z. \*\*\*, \*\*\*, është dhënë cash, pa ndonjë akt të shkruar për shkak të marrëdhënies së posaçme prind - fëmijë. Kjo shumë është siguruar nga z. \*\*\*, \*\*\*, dhe znj. \*\*\*, \*\*\*, nga kursimet e tyre familjare ndër vite dhe mbahej prej tyre në banesë në formë cash”.

27.3 Komisionit, në referencë të nenit 32/4 të ligjit nr. 84/2016, nga analiza financiare e kryer, i ka rezultuar se prindërit e ish-bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për të dhënë hua<sup>13</sup> shumën 25.000 euro znj. \*\*\*, \*\*\*, në vitin 2011, fakt për të cilin i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës.

27.4 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ka deklaruar se: “... ftoj në mënyrë të arsyeshme Komisionin, t’i referohet edhe gjetjeve të KPK<sup>14</sup>, në lidhje me këtë çështje, e cila është trajtuar tashmë nga vetë KPK, dhe në lidhje me të cilën, në dijeninë time, nuk ka pasur konkluzione negative nga KPK. Lidhja e familjes \*\*\* dhe prindërve të ish-bashkëshortes ka qenë një lidhje mjaft e ngushtë familjare. Me aq sa unë kam dijeni, familja \*\*\* ka ndihmuar dhe kontribuar me empati në vazhdimësi për familjen e prindërve të ish-bashkëshortes, pjesë e së cilës para martesës ka qenë edhe vetë ish-bashkëshortja ime, dhe në dijeninë time, i ka mbështetur ata edhe me të ardhura/pension të rregullt, megjithatë unë nuk mund të jap një shpjegim më të detajuar, pasi kjo ka qenë një marrëdhënie private mes tyre. Ju ftoj që të merrni në konsideratë faktin, që kjo hua është marrë përpara martesës sime, për shlyerjen e një kredie, të cilën nuk e kam marrë unë. Gjithashtu unë nuk jam në gjendje të jap shpjegime më të detajuara për një marrëdhënie prind-fëmijë, ku unë nuk kam qenë palë”.

27.5 Gjatë seancës dëgjimore lidhur me këtë shkak, subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar se: “... Duke pasur parasysh që ngjarja i referohet një periudhe në të cilën ai nuk ka qenë i martuar, si dhe duke qenë se aktualisht ai është në pamundësi reale për të marrë informacion më të detajuar, kërkon që këto fakte të merren në konsideratë nga Komisioni”. Subjekti deklaroi se: “... bazuar dhe në vetë provat e administruara nga Komisioni, familja \*\*\* ka pasur të ardhura të mjaftueshme për dhënien e shumës 40.000 lekë prindërve të bashkëshortes. Kjo shumë është përdorur për jetesë nga ana e tyre, por sikur 10.000 lekë nga kjo shumë në muaj ata të kursenin, rezulton që e përmbys atë diferencë dhe ju jep mundësinë prindërve të ish-bashkëshortes, e cila e ka marrë këtë hua para se ai të lidhte martesë me të dhe është shlyer përpara se ai të lidhte martesë me të”.

27.6 Komisioni, për sa më sipër, ka arsyetuar: [...] bazuar dhe në shpjegimet e subjektit në lidhje me huan 25.000 euro konstaton se: (i) Huaja është marrë nga znj. \*\*\*, \*\*\*, te prindërit e saj në vitin 2011, në një kohë kur ajo nuk ka qenë ende e martuar me subjektin e rivlerësimit; (ii) Huaja, të paktën deri në momentin e dhënies së vendimit për ish-bashkëshorten e subjektit, vijon të jetë ende e pashlyer, në shumën e origjinës prej 25.000 euro; (iii) Huaja është marrë në kushtet e një marrëdhënie të posaçme prind - fëmijë midis znj. \*\*\*, \*\*\*, dhe prindërve të saj; (iv) Nga hetimi nuk rezultoi që kjo hua ose një pjesë e saj të jetë shlyer me të ardhurat e subjektit ose gjatë kohë që ai ka qenë i martuar me znj. \*\*\*,; (v) Prindërit e ish-bashkëshortes së subjektit nuk janë subjekte deklarimi dhe, për rrjedhojë, nuk kishin detyrimin ligjor për të

<sup>13</sup> Në përgjigje të pyetësorit standard, bashkëshortja e subjektit, në cilësinë si subjekt rivlerësimi, ka deklaruar se termi “dhurim” para ILDKPKI-së është një gabim material, pasi shuma është dhënë në formën e huas.

<sup>14</sup> Subjekti referon vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*\*.2.2021, të KPK-së, që i përket subjektit të rivlerësimit znj. \*\*\*, \*\*\*,

deklaruar të ardhurat e përfituara nga familja “\*\*\*”; (vi) Familja “\*\*\*” ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për dhënien e shumës 40.000 lekë në muaj prindërve të ish-bashkëshortes; (vii) Shlyerja e huas në bankë, në shumën 24.500 euro, është bërë nëpërmjet një derdhjeje nga znj. \*\*\*. \*\*\*.; (viii) Prindërit e ish-bashkëshortes së subjektit nga analiza financiare rezultojnë me një bilanc negativ në vlerën 959.709,84 lekë, për periudhën 1995-2011... Pas vlerësimit tërësor dhe individual të akteve shkresore dhe shpjegimeve të dhëna prej subjektit të rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit, si dhe referuar kuadrit kushtetues dhe ligjor për vlerësimin e kriterit të pasurisë, sipas nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, vlerëson se detyrimin për të provuar ligjshmërinë e burimit të huas në shumën 25.000 euro e ka pasur ish-bashkëshortja e subjektit, e cila është gjykuar nga një trup tjetër, në kuadër të një hetimi të pavarur dhe të paanshëm. Pavarësisht kësaj, nga hetimi i kryer nga Komisioni, rezultoi se prindërit e ish-bashkëshortes së subjektit kanë pasur të ardhura financiare të mjaftueshme me burime të ligjshme për të mundësuar dhënien e huas ish-bashkëshortes së subjektit në shumën 25.000 euro<sup>15</sup> [...].

27.7 Në përfundim, për pasurinë *Apartament me sip. 125 m<sup>2</sup>, Tiranë*, Komisioni ka vlerësuar se nuk lindin dyshime apo paqartësi. Subjekti ka kryer deklaram të saktë në përputhje me ligjin, si dhe ka burime të ligjshme financiare në lidhje me këtë pasuri.

**28. Komisioneri Publik**, mbështetur edhe në rekomandimin për paraqitje ankimi të ONM-së, ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni, si për mbulimin me burime të ligjshme të subjektit të rivlerësimit të shumës së paguar nga kursimet deri në vitin 2003, ashtu dhe për mundësinë e prindërve të ish-bashkëshortes së subjektit për të mbuluar me burime të ligjshme huan prej 25.000 euro, dhënë ish-bashkëshortes së tij, për të shlyer kredinë pranë \*\*\* Bank, kredi në të cilën vetë subjekti i rivlerësimit ka dalë në cilësinë e dorëzanësit, duke vlerësuar si më poshtë.

**29. Lidhur me burimin e deklaruar të pagesës së këstit të parë, kursime nga të ardhurat nga pagat e periudhës 1995-2000**

29.1 Në deklaramin e tij të parë, DV-2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursime në *cash* në shumën 2.500.00 lekë. Duke pranuar edhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, se të ardhurat e realizuara nga pagat e tij, prej vitit 1995, administroheshin dhe kurseheshin të gjitha, pasi shpenzimet e jetesës mbuloheshin nga prindërit, nga aktet në dosje rezulton se vetëm për të ardhurat në shumën prej 1.226.026 lekë<sup>16</sup>, provohet se janë të ardhura që kualifikohen si të ligjshme, në kuptim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës.

29.2 Për të ardhurat e pretenduara të fituara nga punësimi në sektorin privat në periudhën 1995-2000, të deklaruara si burim për pagesën e këstit të parë të pasurisë, mbetet i paqartë dhe jo i bazuar vlerësimi i Komisionit mbi pamundësinë reale të subjektit, për të provuar pagesën e tatimit në burim për këto të ardhura. Nga aktet në dosje, deklaramat noteriale të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe konfirmimet nga organet tatimore, konstatohet në mënyrë të qartë se punëdhënësit për këtë periudhë konfirmojnë mospagimin e detyrimeve tatimore për z. Gerd Hoxha. Fakt ky i konfirmuar edhe nga përgjigjet respektive të institucioneve përgjegjëse.

<sup>15</sup> Për më tepër, referohuni f. 42-43, të vendimit të Komisionit.

<sup>16</sup> Referuar vërtetimeve të Shkollës së Magjistraturës dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

29.3 Për sa më sipër, në vlerësimin e Komisionerit Publik, për të ardhurat e deklaruara si të përfituara në periudhën 1995-2000, provohet se nuk janë paguar detyrimet tatimore, duke mos plotësuar kështu kriteret e përcaktuara nga neni D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, për t'u konsideruar si të ardhura të ligjshme.

**30. Lidhur me mundësinë financiare të prindërve të znj. \*\*\* për të dhënë hua shumën 25.000 euro, e cila deklarohet se ka shërbyer për shlyerjen e kredisë së marrë nga \*\*\* Bank**

30.1 Nga aktet në dosje, rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Gerd Hoxha, ka nënshkruar në cilësinë e dorëzanësit, për kredisë e marrë nga znj. \*\*\* \*\*\*, në shumën 25.000 euro, pranë \*\*\* Bank sh.a., sipas kontratës së kredisë bankare nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*\*.3.2009<sup>17</sup>, fakt ky i deklaruar dhe nga vetë subjekti në deklaratën periodike vjetore të vitit përkatës.

30.2 **Komisioneri Publik**, mbështetur në rekomandimin për paraqitje ankimi të ONM-së, në konsideratë të situatës faktike të konstatuar se subjekti i rivlerësimit dhe znj. \*\*\* kanë qenë në posedim të këtij apartamenti dhe, njëkohësisht, në marrëdhënie interesi, kohë më parë nga momenti i deklaramit të fitimit të pronësisë, vlerëson se detyrimi për të provuar ligjshmërinë e burimit të huas në shumën 25.000 euro të prindërve të znj. \*\*\*, përdorur në funksion të kësaj pasurie në bashkëpronësi të tyre, i takon edhe subjektit të rivlerësimit, z. Gerd Hoxha.

30.3 Komisioneri Publik, nga verifikimi i akteve në dosje, konstaton se Komisioni, në analizën financiare të kryer për prindërit e znj. \*\*\* \*\*\*, për të justifikuar shumën e dhënë hua deri në datën \*\*\*.2.2011 (datë e shlyerjes së kredisë), ka marrë në konsideratë të ardhurat nga pensionet mujore, si dhe shumën prej 40.000 lekë në muaj, që nga viti 1995. Shumë kjo e deklaruar nga znj. \*\*\*, në cilësinë e subjektit të rivlerësimit, vetëm gjatë hetimit administrativ të kryer ndaj saj, duke deklaruar se kjo shumë është dhënë në formën e ndihmës financiare për prindërit, nga e motra, shtetasja \*\*\* \*\*\*, me qëllim sigurimin e një niveli mesatar jetese.

30.4 Komisioneri Publik vlerëson se analiza financiare, e kryer nga Komisioni në këtë rast, ka nevojë të rishikohet nga Kolegji, pasi shuma prej 40.000 lekë në muaj<sup>18</sup>, sikurse deklarohet edhe në deklaratën noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*\*.6.2018, të shtetasve \*\*\* dhe \*\*\* \*\*\*, ka pasur si qëllim mbulimin e shpenzimeve jetësore të tyre dhe të znj. \*\*\*, të një niveli mesatar. Në këtë rast, analiza e kryer nga Komisioni, duke konsideruar shpenzimet e familjes \*\*\* në minimumin e shpenzimeve sipas ILDKPKI-së, nuk përputhet me deklaramet.

30.5 Gjithashtu, nga analizimi i deklaratave periodike vjetore të ish-bashkëshortes së subjektit, të cilat, bazuar në nenin 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, shërbejnë si provë, rezulton se në deklaratën e saj të parë, të dorëzuar në ILDKPKI, datë 23.3.2005, znj. \*\*\* deklaron: *“të holla, cash të ruajtura në shtëpi, vlera 5.000.000 lekë; pjesa takuese 100%; burimi: nga kursimet e mia dhe të familjes, dhuratë nga motra”*. Në të njëjtën deklaratë, krahas të ardhurave të saj, znj. \*\*\* ka deklaruar dhe të ardhurat e prindërve nga pensioni mujor, në shumat respektive 10.500 lekë në muaj për babain dhe 7.000 lekë në muaj për nënën. Bazuar në këto

<sup>17</sup> Qëllimi i kredisë është financimi i shumë prej 25.000 euro znj. \*\*\*, me qëllim rikonstruksionin e apartamentit prej 125 m<sup>2</sup>, në Tiranë, të cilin subjekti dhe znj. \*\*\* kishin planifikuar ta blinin nga znj. \*\*\* \*\*\*. Sipas kontratës së hipotekës nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\*\* kol., datë \*\*\*.3.2009. Si garanci për sigurimin e kredisë, është lënë i njëjti apartament, i cili në momentin e marrjes së kredisë nga subjekti ka qenë në titull pronësie të znj. \*\*\* \*\*\*.

<sup>18</sup> Shuma 40.000 lekë deklarohet për herë të parë si burim gjatë hetimit administrativ të znj. \*\*\*, pasi në deklaratën e saj të parë, dorëzuar në ILDKPKI, dt. 23.3.2005, në formularin e të ardhurave, znj. \*\*\*, kur deklaron të ardhurat e prindërve, specifikon vetëm ato nga pensioni mujor, në shumat respektive 10.500 lekë në muaj për babain dhe 7.000 lekë në muaj për nënën.

deklarime, duket se gjithë të ardhurat e znj. \*\*\* dhe prindërve të saj, deri në fund të vitit 2004, kanë shërbyer si burim krijimi të shumës së kursimeve *cash*, të deklaruara prej saj në shumën 5.000.000 lekë. Nisur nga ky konstatim, vlerësojmë se analiza financiare mbi mundësinë e prindërve të znj. \*\*\* për të mbuluar me burime të ligjshme shumën 25.000 euro në vitin 2011, duhej të ishte kryer për periudhën 1.1.2005 e deri në momentin e dhënies së huas.

30.6 Për sa më sipër, në vlerësimin e Komisionerit Publik, çmohet e nevojshme rivlerësimi i mundësisë financiare të prindërve të znj. \*\*\*, për t'i dhënë hua kësaj të fundit shumën 25.000 euro në vitin 2011, duke rivlerësuar të gjitha burimet e deklaruara dhe të pretenduara.

30.7 Duke përfunduar, Komisioneri Publik vlerëson se, për sa i përket burimeve të ligjshme të krijimit të pasurisë *Apartament me sip. 125 m<sup>2</sup>, Tiranë*, deklaruar respektivisht: (i) kursime në *cash* të subjektit të rivlerësimit në shumën 1.500.000 lekë dhe (ii) hua në shumën 25.000 euro (përdorur për mobilim), marrë nga prindërit e ish-bashkëshortes së subjektit, janë elemente që duhen të rivlerësohen nga Kolegji në kuadër të analizës financiare, lidhur me mjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme të krijimit të saj, me qëllim arritjen në përfundimin se subjekti i rivlerësimit është i besueshëm nga vlerësimi i kriterit të pasurisë.

**31. Pasuria nr. 2, Apartament banimi me sip. 126,5m<sup>2</sup>, ndodhur në Vlorë (në vijim referuar si “Apartament me sip. 126,5 m<sup>2</sup>, Vlorë”)**

31.1 Në D-Vett., subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Apartament banimi me sip. 126,5 m<sup>2</sup> (verandë + banesë), nr. pasuri \*\*\*/\*\*\*/\*\*\*+\*\*\*-\*\*\* z.k.\*\*\*, Vlorë, tërësisht i mobiluar. Vlera e pasurisë: 55.452 euro. Burimi i krijimit: kursimet e mia dhe të bashkëshortes sime, të realizuara gjatë gjithë jetës sonë, sipas përshkrimit të bërë në deklaratat tona të pasurisë, për efekt të ligjit nr. 84/2016. Pjesa takuese: 50% në bashkëpronësi me bashkëshorten \*\*\* \*\*\*.*

31.2 Në DV-2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të njëjtën pasuri saktësisht si më sipër.

31.3 Nga dokumentacioni i përcjellë nga ASHK Vlorë, me shkresë nr. \*\*\*/\*\*\* prot., datë \*\*\*.7.2020, rezulton se origjina e kësaj pasurie rrjedh nga kontrata e shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*\*.9.2016, lidhur pranë noteres \*\*\* \*\*\*, me palë shitëse \*\*\* dhe \*\*\* \*\*\* dhe palë blerëse subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij. Shuma është depozituar në *cash*, në datën \*\*\*.9.2016, nga vetë subjekti i rivlerësimit, në llogarinë e noteres pranë Bankës \*\*\* \*\*\*.

31.4 Në përfundim të hetimit administrativ për këtë pasuri, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit shpjegime në lidhje me burimin e shumës 5.000.000 lekë të ish-bashkëshortes, pasi ka konstatuar se: (i) zonja \*\*\*, në DV-2004, ka deklaruar si burim për këtë shumë kursimet e saj dhe të familjes, dhuratë nga motra; (ii) në deklaratën noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*\*.6.2018, të lëshuar nga \*\*\* dhe \*\*\* \*\*\*, si burim i kësaj shume deklarohen, përveç vlerës 2.000.000 lekë të dhuruar, edhe të ardhurat e zonjës \*\*\* nga punësimi pranë biznesit të tyre të ndërtimit dhe qiradhënies me pagë mujore 35.000 lekë.

31.5 Ndërkohë, nga analiza financiare e të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën deri në datën \*\*\*.9.2016 (momenti i blerjes së pasurisë), Komisionit i ka rezultuar se subjekti dhe personat e lidhur me të nuk mbulojnë me burime të ligjshme krijimin e kursimeve *cash*, të

përdorura për blerjen e këtij apartamenti, për një diferencë negative prej - 971.505,59 lekë<sup>19</sup>, fakt për të cilin i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës.

31.6 Lidhur me mospërputhjen në burimet e deklaruara të kursimeve në shumën 5.000.000 lekë, subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e tij, ka kërkuar nga trupi gjykues t'i referohet gjetjeve dhe konkluzioneve të Komisionit, në lidhje me këtë çështje, e cila është trajtuar nga një trup tjetër gjykues (për qëllim të procesit të rivlerësimit kalimtar të znj. \*\*\*), duke qenë se ai nuk është në gjendje, aktualisht, të japë shpjegime më të detajuara apo shteruese në lidhje me këtë shumë.

31.7 Lidhur me pamjaftueshmërinë financiare të konstatuar, subjekti, në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera, ka parashtruar pretendimet e tij se Komisioni nuk ka konsideruar në analizën financiare disa kategori të kursimeve *cash* ndër vite, respektivisht:

- (i) Të ardhurat në shumën prej 1.500.000 lekë, nga puna në sektorin privat dhe vetëpunësimi;
- (ii) Të ardhur nga shitja e automjetit me targë TR\*\*\*, në shumën 1.200.000 lekë, në vitin 2011, për të cilat ka deklaruar se posedoheshin në *cash* në fund të vitit 2011;
- (iii) Të ardhura të tjera të kursyera në *cash* të ish-bashkëshortes për vitet e deklarimit<sup>20</sup>, duke pretenduar shumën e kursimeve në total për vitet 2006, 2007, 2008 dhe 2010, në vlerën 2.335.000 lekë, ndryshe nga kursimet e llogaritura nga ana e Komisionit, në vlerën prej 1.000.000 lekë.

31.8 Komisioni, në përfundim, për këtë pasuri ka arsyetuar se: [...] *pas përfshirjes në analizë të: (i) kursimeve cash të deklaruar ndër vite nga ish-bashkëshortja; (ii) konsiderimit si kursime cash në vitin 2004 të shumës 1.500.000 lekë, duke pranuar të ardhurat nga puna me kohë të pjesshme e subjektit për periudhën 1995-2000; (iii) shumës 1.200.000 lekë si shtesë e gjendjes cash e subjektit në vitin 2011; rezulton se subjekti së bashku me ish-bashkëshorten e tij kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e apartamentit në qytetin e Vlorës<sup>21</sup> [...].*

**32. Komisioneri Publik**, mbështetur në rekomandimin për paraqitje ankimi të ONM-së, si dhe në jurisprudencën e Kolegjit, vlerëson se kursimet *cash* të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, janë elemente që do të duhet të analizohen në kuadër të ligjshmërisë së të ardhurave të përdorura si burim për krijimin e kësaj pasurie, pasi:

32.1 Në lidhje me përfundimet e arritura nga Komisioni për të ardhurat e pretenduara nga subjekti nga puna e tij me kohë të pjesshme, për periudhën 1995-2000, sikundër trajtuar dhe më sipër, në vlerësimin e Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit nuk gjendet në kushtet e parashikuara nga pika 32/2 e ligjit nr. 84/2016 dhe këto të ardhura nuk plotësojnë kushtet e nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, për t'u konsideruar si të ardhura të ligjshme.

32.2 Në lidhje me kursimet në *cash* të vitit 2011, me burim të ardhura nga shitja e automjetit, nga verifikimi i DV-2011 të subjektit të rivlerësimit, e cila për këtë proces ka vlerën e provës, nuk rezulton të jenë deklaruar disponimi i kursimeve në *cash* në këtë vlerë, dhe si të tilla, bazuar

<sup>19</sup> Duket se Komisioni në këtë analizë nuk ka konsideruar gjendjen e deklaruar si kursime *cash* në vitin 2004, prej 1.500.000 lekë.

<sup>20</sup> Pretendimet e subjektit shtrihen mbi deklaratimet e kursimeve në *cash* të ish-bashkëshortes për periudhat 2006-2010.

<sup>21</sup> Për më tepër, referohuni në f. 25, të vendimit.

dhe në jurisprudencën e Kolegjit, nuk mund të konsiderohen në mesin e kursimeve *cash* që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit në vitin 2016.

32.3 Deklarimet periodike vjetore të pasurisë të ish-bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit mbi kursimet në *cash* të periudhës 2006-2010, të dorëzuara pranë ILDKPKI-së, nuk mbështesin pretendimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ.

32.4 Për sa më sipër, në vlerësimin e Komisionerit Publik, çmohet e nevojshme rivlerësimi i zërave përbërës të analizës financiare dhe mundësisë së subjektit të rivlerësimit dhe ish-bashkëshortes së tij, për të mbuluar me burime të ligjshme, kursimet e deklaruara ndër vite të përdorura për blerjen e kësaj pasurie.

### **33. Automjeti në pronësi të shtetasit \*\*\*. \*\*\*. dhe në përdorim të subjektit të rivlerësimit**

33.1 Në D.Vett., subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Automjet tip "Audi" me targë AA \*\*\* , në pronësi të babait \*\*\*. \*\*\*., në përdorim nga unë, sipas kontratës së huapërdorjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., dt. \*\*\*.7.2011, redaktuar nga notere \*\*\* \*\*\*, Tiranë.*

33.2 Gjatë hetimit administrativ të Komisionit, në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se: *"... gjatë shtatë viteve të fundit (2011 – 2017) kam pasur në përdorim së bashku me bashkëshorten time, znj. \*\*\* \*\*\*, automjetin e babait tim, z. \*\*\* \*\*\*, tip "Audi", me targa AA\*\*\*. Ky automjet është përdorur nga ne vetëm për udhëtimet jashtë vendit me makinë dhe aktualisht është shitur nga z. \*\*\* \*\*\*, dhe nuk është më në pronësi të tij".*

33.3 Nga hetimi administrativ ka rezultuar se ky automjet është blerë nga babai i subjektit të rivlerësimit për shumën 37.000 USD dhe janë paguar detyrime doganore 931.091 lekë. Nga lëvizjet e llogarisë së babait të subjektit, në \*\*\* Bank, rezulton se:

- (i) Në datën 25.4.2011, z. \*\*\*. \*\*\* ka depozituar shumën 15.000 USD;
- (ii) Në datën 25.4.2011, z. \*\*\*. \*\*\* i është transferuar shuma 12.102 USD nga z. \*\*\* \*\*\*, me emërtimin: *"borxh për blerjen e makinës"*;
- (iii) Në datën 25.4.2011, z. \*\*\*. \*\*\* i është transferuar shuma 10.000 USD nga znj. \*\*\* \*\*\*, me emërtimin: *"borxh për blerje makine"*;
- (iv) Në datën 25.4.2011, z. \*\*\*. \*\*\* ka transferuar shumën 37.000 USD në llogari të \*\*\* dhe \*\*\* \*\*\* (shitësit e automjetit në SHBA).

33.4 Nga të dhënat e AMF-së ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit së bashku me ish-bashkëshorten janë mbajtës të policave të sigurimit për këtë mjet, për periudhat të ndryshme gjatë viteve 2011-2017<sup>22</sup>.

33.5 Komisioni, në referencë të nenit 32/4 të ligjit nr. 84/2016, ka kryer analizën financiare për të verifikuar mundësinë e personit tjetër të lidhur, babait të subjektit të rivlerësimit, për të justifikuar me burime të ligjshme blerjen e pasurisë autoveturë, nga ku ka rezultuar se ai ka qenë në pamundësi financiare në - 680.148.14 lekë. Për pasojë, subjekti të rivlerësimit i është

<sup>22</sup> \*\*\*.7.2016 - \*\*\*.7.2017; \*\*\*.7.2015 - \*\*\*.7.2016; \*\*\*.7.2013 - \*\*\*.7.2014; \*\*\*.7.2012 - \*\*\*.7.2013; \*\*\*.7.2011-\*\*\*.6.2012; \*\*\*.3.2018 - \*\*\*.3.2018; \*\*\*.2.2017 - \*\*\*.2.2017; \*\*\*.11.2016 - \*\*\*.12.2016; \*\*\*.8.2016 - \*\*\*.9.2016; \*\*\*.3.2016 - \*\*\*.3.2016; \*\*\*.12.2015 - \*\*\*.1.2016; \*\*\*.11.2015 - \*\*\*.12.2015; \*\*\*.8.2015 - \*\*\*.9.2015; \*\*\*.1.2013 - \*\*\*.1.2014; \*\*\*.10.2012 - \*\*\*.1.2013; \*\*\*.9.2012 - \*\*\*.9.2012; \*\*\*.4.2012 - \*\*\*.4.2012; \*\*\*.1.2012 - \*\*\*.1.2012; \*\*\*.11.2011 - \*\*\*.12.2011; \*\*\*.8.2011 - \*\*\*.10.2011; \*\*\*.7.2011 - \*\*\*.7.2011. Ndërkohë, ish-bashkëshortja e subjektit, përveç sa më lart, rezulton si policëmbajtëse e policës të sigurimit për këtë mjet dhe për periudhën \*\*\*.7.2017 - \*\*\*.7.2018.

kaluar barra e provës, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D, pika 5 e aneksit të Kushtetutës.

33.6 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera, ka kërkuar përfshirjen në analizën financiare edhe të të ardhurave të dy motrave të tij, pjesë në atë kohë e trungut familjar dhe që jetonin në familjen e të atit, znj. \*\*\*. \*\*\*, dhe znj. \*\*\*. \*\*\*, \*\*\*, të ardhurat dhe burimi i të cilave i është vënë në dispozicion Komisionit, së bashku me evidencat e vërtetimeve dhe/ose dëshmime të pagesave të tatimeve dhe kontributeve përkatëse<sup>23</sup>.

33.7 Komisioni, pasi ka arsyetuar se në analizë duhen përfshirë të ardhurat e znj. \*\*\*. \*\*\*, deri në vitin 2010, kur ajo është larguar nga trungu familjar, dhe jo të ardhurat e motrës, znj. \*\*\*. \*\*\*, apo shpenzime për të<sup>24</sup>, ka vlerësuar: [...] *se nga analiza financiare rezulton se babai i subjektit ka pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e këtij automjeti. Komisioni ka mbajtur në konsideratë faktin që kjo analizë i përket babait të subjektit, i cili, si ai, ashtu edhe familjarët e tij, nuk kanë qenë subjekte deklaruese dhe, për rrjedhojë, nuk kanë pasur detyrimin e deklarimit të të ardhurave, si dhe faktit që në mungesë të të dhënave të plota ka qenë objektivisht e pamundur për të kryer një analizë të saktë dhe të mirëfilltë të gjendjes së tyre financiare [...].*

**34. Komisioneri Publik**, mbështetur në rekomandimin për paraqitje ankimi të ONM-së, si dhe në jurisprudencën e Kolegjit, vlerëson se arsyetimi dhe konkluzionet e Komisionit mbi burimet e ligjshme të personave të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, janë elemente që do të duhet të analizohen dhe kontrollohen nga ana e Kolegjit, pasi analiza financiare e kryer nga Komisioni paraqet disa mangësi, si më poshtë vijon.

34.1 Subjekti i rivlerësimit, duke qenë subjekt deklarues që prej vitit 2003 e në vijim, ka deklaruar në çdo deklaratë periodike vjetore shumat e kursyera në *cash* në fund të vitit (kursime të cilat më vonë janë deklaruar të përdorura për blerjen e pasurisë nr. 2, trajtuar më sipër), duke mos deklaruar kursime të tjera përveç këtyre.

34.2 Në deklaratën noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., të datës \*\*\*.9.2020, të shtetasve \*\*\* dhe \*\*\* \*\*\*, rezulton se këta të fundit, ndër të tjera, kanë deklaruar: “... *deri në periudhën e shkëputjes së secilit prej fëmijëve nga trungu, ekonomia familjare ka qenë e përbashkët... fëmijët kanë ndjekur shkollat dhe specializimet përkatëse. Për pasojë, shpenzimet e tyre përballoheshin nga prindërit, duke i lejuar që të kursenin sa më shumë të ardhura nga punësimi i tyre, gjatë periudhës së shkollës dhe më pas, me qëllim përdorimin e këtyre të ardhurave në momentin e daljes si familje më vetë të secilit prej tyre... ”.*

34.3 Në vlerësimin e Komisioneri Publik, zërat e analizës financiare të kryer për personin tjetër të lidhur, \*\*\*. \*\*\*, duhet të rishikohen dhe rivlerësohen nga ana e Kolegjit. Bazuar në deklaratën noteriale të mësipërme, referuar edhe pretendimeve dhe deklarimeve të subjektit mbi kursimet e deklaruara deri në fund të vitit 2003, vlerësojmë se të ardhurat e subjektit të

<sup>23</sup> Subjekti gjatë hetimit administrativ ka vënë në dispozicion dokumentacion dhe vërtetime pagash për periudhën në fjalë.

<sup>24</sup> Trupi gjykues për këtë arsyetim i është referuar vendimit nr. \*\*\*, datë \*\*\*.10.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket motrës së subjektit të rivlerësimit, znj. \*\*\*. \*\*\*, nga i cili, rezulton se ajo ka deklaruar si kursime *cash* para detyrës shumë 700.000 lekë. Komisioni nuk ka përfshirë në analizën financiare të z. \*\*\*. \*\*\*, shpenzimet jetike të znj. \*\*\*, për periudhën që ajo ka qenë e punësuar, për sa kohë provohet që ajo ka krijuar të ardhura personale, si dhe duke marrë në konsideratë faktin se znj. \*\*\*. \*\*\*, ka pasur kursime *cash* shumë 700.000 lekë. Ndërkohë, shuma tjetër që ajo ka përfutuar nga punësimi, rrjedhimisht, ka shërbyer për të mbuluar shpenzimet jetike, të cilat i janë llogaritur në analizën e z. \*\*\*. \*\*\*.



rivlerësimit dhe të motrës së tij, znj. \*\*\*, \*\*\*, nuk duhen të përfshiheshin në mesin e burimeve të ligjshme të personit tjetër të lidhur, z. \*\*\*, \*\*\*, për blerjen e pasurisë automjet “Audi”.

34.4 Rivlerësimi i fakteve dhe i rrethanave mbi burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie, përdorimi dhe përgjegjësia fizike e së cilës i kaloi subjektit të rivlerësimit një javë mbas nxjerrjes së lejes së qarkullimit<sup>25</sup>, çmohet i nevojshëm, pasi eventualisht, nga kjo situatë faktike duket se subjekti i rivlerësimit ka qenë pronari *de facto* i këtij aseti, duke u ndodhur në kushtet e nenit D, pika 5 e aneksit të Kushtetutës.

### **35. Pasuria nr. 4, Automjet tip “Citroen C4”, blerë në vitin 2012 dhe shitur në vitin 2016**

35.1 Në D-Vett., subjekti i rivlerësimit ka deklaruar automjet tip “Toyota” me targë TR \*\*\*, blerë me shumën e përfitur nga shitja e automjetit tip “Citroen C4”, me targë AA \*\*\*. Po në deklaraten “Vetting”, subjekti ka deklaruar: *Të ardhura neto, të siguruara nga shitja e automjetit tip “Citroen C4”, me targë AA \*\*\*, te personi fizik \*\*\* sipas kontratës së shitjes së automjetit nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., dt.\*\*\*.11.2016, redaktuar nga notere \*\*\* Tiranë. Vlera: 10.500 euro (në bashkëpronësi me bashkëshorten, znj. \*\*\* \*\*\*)*.

35.2 Në DV-2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *pakësim të ardhurash për blerje automjeti tip “Toyota”, me targë TR \*\*\*, blerë nga shuma e përfitur nga shitja e automjetit tip “Citroen C 4”, me targë AA \*\*\*. Vlera: 5.000 euro.*

35.3 Lidhur me burimin e blerjes së kësaj pasurie rezulton se:

35.4 Në DV-2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Marrje në përdorim dhe posedim i automjetit tip “Citroen C4”, me targë AA \*\*\*, me anë të kontratës së qirasë financiare (leasing) lidhur me shoqërinë “\*\*\* \*\*\*” sh.a., nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., dt.\*\*\*.8.2012, dhe shtojcës nr. \*\*\*, qiraja nr. \*\*\*, vërtetuar nga notere \*\*\* \*\*\*, Tiranë. Kontrata përfundon me dt. \*\*\*.8.2017. Shuma prej 9.679,47 euro, e paguar, është siguruar në mënyrë të barabartë, nga kursimet personale të miat dhe të bashkëshortes sime. Vlera e sendit është 16.500 euro. Pjesa takuese: 50%.*

35.5 Deklarimi i subjektit si më sipër konfirmohet dhe nga DPSHTRR-ja me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.2.2019. Kjo pasuri rezulton e përfitur me kontratën e qirasë financiare me nr. \*\*\* rep. dhe nr. \*\*\* kol., datë \*\*\*.8.2012, me palë shitëse shoqëria “\*\*\* \*\*\*” sh.a., dhe palë blerëse subjektin e rivlerësimit dhe znj. \*\*\* \*\*\*, kundrejt çmimit 16.500 euro, nga të cilat pjesa prej 54.5% është likuiduar nga pala blerëse (në DV e vitit respektiv deklarohet pagesa e shumës 9.000 euro), në momentin e nënshkrimit të kontratës dhe pjesa tjetër nëpërmjet qirasë financiare më këste mujore.

35.6 Komisionit, nga analiza e burimeve të blerjes së automjetit “Citroen C4”, shitja e të cilit ka shërbyer më pas si burim për automjetin “Toyota”, deklaruar në D-Vett., i ka rezultuar se deri në datën \*\*\*.8.2012, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, nuk kanë pasur mundësi financiare për blerjen e këtij automjeti, për një diferencë negative në shumën - 687.222,17 lekë, fakt për të cilin i ka kaluar subjektit barrën e provës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

<sup>25</sup> Leja e qarkullimit ka dalë në emër të z.\*\*\*. \*\*\*, në datë \*\*\*.7.2011 dhe me kontratën e huapërdorjes së datës \*\*\*.7.2011, automjeti ka kaluar në përdorim subjektit të rivlerësimit.

35.7 Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e tij të datës 21.5.2021, i është referuar të njëjtave përgjigje sikundër atyre të dhëna për pasurinë “Apartament me sip. 128 m<sup>2</sup>, Vlorë”, duke parashtruar, ndër të tjera, edhe pretendime mbi “*përfshirjen e të ardhurave nga shitja e automjetit me targë TR\*\*\*, në shumën 1.200.000 lekë, në vitin 2011, për të cilat ka deklaruar se posedoheshin në cash në fund të vitit 2011*”.

35.8 Komisioni ka vlerësuar të përfshijë në analizën financiare shumën e pretenduar nga subjekti, të disponuar në *cash*, në vlerën 1.200.000 lekë në vitin 2011, si dhe pakësimin nga kursimet në *cash* të subjektit dhe bashkëshortes së tij, si burim për blerjen e automjetit në vitin 2012. Në përfundim, Komisioni ka arsyetuar se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me automjetin tip “Toyota”. Subjekti ka kryer deklarim të saktë në përputhje me ligjin, si dhe ka burime të ligjshme financiare në lidhje me këtë pasuri.

35.9 **Komisioneri Publik**, mbështetur në rekomandimin për paraqitje ankimi të ONM-së, si dhe bazuar në jurisprudencën e Kolegjit, vlerëson se mbetet i nevojshëm rivlerësimi nga ana e Kolegjit i bazueshmërisë së argumenteve të përdorura nga Komisioni, lidhur me këto kursime, çka do të ndikonte në mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, për të mbuluar me burime të ligjshme shpenzimet, kursimet dhe investimet e këtyre viteve.

#### **V.B. Për kontrollin e kriterit të aftësive profesionale**

36. Nga hetimi administrativ i Komisionit për vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, bazuar në përcaktimet e nenit E, të aneksit kushtetues, kreut VI të ligjit nr. 84/2016 dhe, për aq sa gjen zbatim, ligji nr. 96/2016, i ndryshuar, kanë rezultuar disa gjetje dhe mangësi, të tilla që, për nga provueshmëria e tyre sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, i kanë kaluar si barrë prove subjektit të rivlerësimit, për të paraqitur prova dhe për të dhënë shpjegime për të kundërtën.

37. Sikurse kemi referuar edhe në hyrje të këtij ankimi (prg. 8), gjatë hetimit administrativ, Komisioni ka administruar *një mendim* dhe *dy gjetje* nga ana e vëzhguesit ndërkombëtar të ONM-së, në të cilat, në mënyrë të përmbledhur, parashtrohen konkluzionet se:

37.1 *Mendimi i vëzhguesit*. Në dosjen gjyqësore nr. 1 (nga 5 dosjet gjyqësore të përzgjedhura me short), ndodhemi përpara ekzistencës së “gabimeve thelbësore dhe serioze”, të kryera nga subjekti i rivlerësimit, siç përcaktohet në pikën 45, të vlerësimit profesional (të KLGJ-së), siç përcaktohet nga pika 54, e vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017, i datës 18 janar 2017, i cili duhet ta çojë Komisionin të konkludojë në lidhje me mosekzistencën e kriterëve të parashikuara nga neni 59, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, interpretuar së bashku me nenin E, pika 5, e aneksit të Kushtetutës.

37.2 *Në gjetjen e parë*, datë 13.1.2020 (protokolluar pranë Komisionit me nr. 48), vlerësohet se:

- Ekzistenca e një standardi ligjor sipas interpretimit të orientuar nga Kushtetuta, të nenit 18 të ligjit nr. 8811/2001 (që në atë kohë ka qenë në fuqi), të ndryshuar, duke pasur parasysh nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në kuptimin që “kolegjialiteti” i KLD-së nuk e liron secilin magjistrat nga përgjegjësia që t’i bëhet vlerësim negativ, në bazë të pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, sa herë që po këta magjistratë kanë miratuar një vendim të KLD-së në shkelje flagrante të kuadrit ligjor përkatës, apo që kanë marrë pjesë në votim, që ka kontribuar në nxjerrjen e një vendimi të tillë.

- Shkelje flagrante, në procesin që e çoi KLD-në, më datë \*\*\* tetor 2018, t'i jepte \*\*\*. \*\*\*, leje për periudhën nga \*\*\* nëntor 2018 deri në \*\*\* tetor 2020 dhe, posaçërisht, shkeljet flagrante dhe të hapura të dispozitave të pikës 6, të nenit 22, pikës 2, të nenit 24 dhe pikës 2, të nenit 25, të ligjit nr. 8811/2001, të ndryshuar, siç ka qenë në fuqi në atë kohë, si dhe të pikës 2, të nenit 24, të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar.

37.3 Në gjetjen e dytë, datë 20.01.2020 (protokolluar pranë Komisionit me nr. 94), vlerësohet se:

- Ekzistenca e një standardi ligjor, sipas interpretimit të orientuar nga Kushtetuta të nenit 18 të ligjit nr. 8811/2001 (që në atë kohë ka qenë në fuqi), të ndryshuar, duke pasur parasysh nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në kuptimin që “kolegjialiteti” i KLD-së nuk e liron secilin magjistrat nga përgjegjësia që t'i bëhet vlerësim negativ, në bazë të pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, sa herë që po këta magjistratë kanë miratuar një vendim të KLD-së në shkelje flagrante të kuadrit ligjor përkatës apo kanë marrë pjesë në votim, që ka kontribuar në nxjerrjen e një vendimi të tillë.
- Mungesa e përgjegjësive penale për një veprim të parashikuar në nenin 257/a të Kodit Penal, nuk e ndalon KLD-në që të vlerësojë ekzistencën e një shkeljeje disiplinore në bazë të legjislacionit në fuqi dhe se procedimet disiplinore dhe ato penale mund të trajtohen në mënyrë autonome (me kusht që elementet e krimit dhe/ose të shkeljes disiplinore të vërtetohen në procedimin përkatës).
- Ligji i zbatueshëm i asaj kohe për vlerësimin e kërkesës së Ministrisë së Drejtësisë, nuk parashikonte asnjë nënshtrim të hetimit disiplinor, me qëllim vërtetimin e shkeljeve disiplinore të përshkruara në shkronjën “ç”, të pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 9877/2008, që ka qenë atëherë në fuqi, dhe dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra në fund, për ekzistencën e përgjegjësive penale për të njëjtat veprime që përshkruhen në nenin 257/a të Kodit Penal të Shqipërisë, që ishte i zbatueshëm për atë çështje, siç ishte në fuqi atëherë.
- Elementet për vlerësimin e ekzistencës së shkeljes disiplinore, që përshkruhen në shkronjën “ç”, të pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 9877/2008, janë të ndryshme nga elementet për të vlerësuar ekzistencën e krimit të parashikuar nga neni 257/a i Kodit Penal të Shqipërisë dhe se, në veçanti, shkronja “ç” e pikës 2, e nenit 32, e ligjit të mëparshëm nr. 9877/2008 nuk parashikon, si parakusht, ekzistencën e ndonjë mase të mëparshme administrative (si për shembull, masë disiplinore nga KLD-ja apo gjoba të vendosura nga organe të tjera administrative – si ILDKPKI-ja).

**38.** Komisioni, pasi ka administruar dhe vlerësuar mendimin dhe dy gjetjet e mësipërme, në referencë të nenit B, pika 3, germa “b” e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 49, pikat 10 dhe 11, të ligjit nr. 84/2016, si dhe pasi ka administruar provat dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit për të kundërtën e barrës së provës lidhur me to, në mënyrë të përmbledhur, ka vlerësuar se:

38.1 [...] Në lidhje me dosjen 1 konstaton se subjekti ka arritur të provojë bindshëm të gjitha pasaktësitë e konstatuara nga ana e KLGJ-së. Nga provat e administruara, duke i krahasuar me atë që gjenden në dosjen e vlerësimit profesional nga ana e KLGJ-së, konstatohen se kjo e fundit nuk është e plotë... Në lidhje me kohëzgjatjen e gjyqimit, si dhe me dorëzimin me vonesë të vendimit, Komisioni vlerëson se nga ana e subjektit është provuar që këto vonesa kanë ardhur si pasojë e ngarkesës së madhe të tij në punë, kompleksitetit të çështjes, shtyrjes së seancave nga palët në proces, si dhe shtyrjes të disa seancave për shkaqe që lidhen me

*impinjime të tjera të tij, për të cilat subjekti duhej të ishte treguar më i kujdesshëm për të shmangur përplasjen e datave. Nga vëzhgimi i dosjes gjyqësore rezulton se subjekti ka marrë të gjitha masat për njoftimin e palëve. Pavarësisht vonesave të krijuara në lidhje me kohën e gjykimit, si dhe të zbardhjes së vendimit, Komisioni vlerëson se ato nuk mund të konsiderohen si shkaqe për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit ndaj subjektit të rivlerësimit, për sa kohë nuk janë shkaktuar për mungesë të organizimit të punës nga ana e subjektit. Në përfundim, Komisioni vlerëson se, në lidhje me dosjen nr. 1, nuk gjenden “gabime thelbësore dhe serioze”, siç përcaktohet nga pika 54 e vendimit të Gjykatës Kushtetuese, nr. 2/2017, datë 18.1.2017 [...]<sup>26</sup>.*

38.2 Ndërsa për dy gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar, Komisioni ka vlerësuar se: [...] *pasi analizoi dhe vlerësoi shpjegimet e subjektit, kushtet dhe rrethanat, veprimet e tij, si dhe pasojat e ardhura, çmon se nuk jemi përpara shkeljeve që e bëjnë magjistratin të papërshtatshëm për të ushtruar funksionin e tij si magjistrat. Komisioni mban qëndrimin se subjekti, në cilësinë e anëtarit të KLD-së, nuk arsyetoi bindshëm lidhur me gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar, duke konkluduar se veprimtaria e subjektit të rivlerësimit, në funksionin e tij si anëtar i KLD-së për këto dy raste, brenda një afati 5-vjeçar, në zbatim të pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, duhet të jetë objekt i një hetimi të plotë nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, përgjegjës për hetimin e shkeljeve disiplinore ndaj gjyqtarit dhe gjithë veprimtarisë së ushtruar prej tij në funksion të këtij statusi, për të arritur në një konkluzion në lidhje me këto aspekte të punës së këtij magjistrati [...]*<sup>27</sup>.

**39. Komisioneri Publik**, mbështetur në rekomandimin për paraqitje ankimi të ONM-së, përmbajtjes së mendimit dhe dy gjetjeve të vëzhguesit ndërkombëtar, duke i bërë këto të fundit pjesë të shkaqeve të ankimit, çmon se përfundimi i Komisionit nuk është rrjedhojë e një vlerësimi tërësor të fakteve dhe interpretimit të drejtë të ligjit të posaçëm. Bazuar në një vlerësim të përgjithshëm të të tria kritereve apo vlerësim tërësor të çështjes, duket se aplikimi i nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, në rastin konkret nuk është plotësisht i bazuar. Referuar fakteve dhe rrethanave të prezantuara në dy gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar (përfshirë dhe mendimin), duket se në arsyetimin e Komisionit mungon vlerësimi nëse për rastin konkret gjen zbatim neni 61/5, i ligjit nr. 84/2016.

39.1 Vlerësimi i mësipërm bazohet edhe në jurisprudencën e Kolegjit, i cili, lidhur me aplikimin e nenit 59, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, në vendimin orientues (JR) nr. 2/2020, prg. 15.4, ndër të tjera, është shprehur se: [...] *Kjo dispozitë gjen zbatim në rastet kur subjekti është konfirmuar në detyrë për efekt të përfundimit të procesit kalimtar të rivlerësimit, por ndërkohë nga ana e Komisionit janë evidentuar shkaqe që mund të përbëjnë shkelje disiplinore, të cilat organi rivlerësues i konsideron jo të asaj shkalle dhe rëndësie, sa të vetme e në mënyrë të pavarur, sipas nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, apo nga vlerësimi tërësor i çështjes sipas nenit 61, pika 5 e këtij ligji, të përbëjnë shkak shkarkimi për subjektin e rivlerësimit, referuar nenit 58, pika 1, germa “c” dhe nenit 59, pika 2, lidhur me nenin 61, pika 4, si dhe me nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 [...].*

<sup>26</sup> Për më tepër referohuni në prg. 38.5.4, f. 52, të vendimit.

<sup>27</sup> Për më tepër referohuni në prg. 40.4, f. 63, të vendimit.

39.2 Duke përfunduar për sa më sipër, Komisioneri Publik në analizë të provave dhe akteve të administruara, vlerëson se përfundimi i Komisionit është i cenushtëm dhe kontrolli i Kolegjit në këtë rast është i nevojshëm, duke çmuar gjetjet, në cilësinë e provës që dëshmon faktin, rrethanën apo standardin ligjor të parashtruar në të. Në këtë cilësi, atë të provës, ato duhet të merren në shqyrtim në përmbajtjen e tyre, proces i cili do të sigurojë që ai (subjekti), me të vërtetë, të ketë besimin e publikut, rivendosja e të cilit është qëllimi kryesor i procesit të rivlerësimit dhe i institucioneve që e zbatojnë atë.

## **VI. Kërkimi i ankimit**

**40.** Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se hetimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave nuk ka qenë i plotë dhe i gjithanshëm për krijimin e bindjes së subjekti i rivlerësimit arrin nivel të besueshëm, në kuptim të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

**41.** Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

**42.** Bazuar në kërkesat e neneve Ç, D, DH, E dhe F, të aneksit të Kushtetutës, neneve 30-34, 40- 44, pikave 3, 4 dhe 5 të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016;

**43.** Kërkojmë që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit dhe, në zbatim të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, të vendosë në mënyrë alternative:

- Ndryshimin

ose

- Lënien në fuqi të vendimit nr. 393, datë 3.6.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

## **KOMISIONERI PUBLIK**

**Darjel SINA**

I bashkëlidhet këtij ankimi:

- Rekomandimi për ushtrim ankimi i ONM-së, nr. 437/1 prot., datë 8.7.2021.

## International Monitoring Operation

Project for the Support to the Process of Temporary  
Re-evaluation of Judges and Prosecutors in Albania



Funded by the European Union and  
the Austrian Development Agency



12<sup>30</sup>

Prot. No. 437/1

Tirana, 08 July 2021

To the

**Public Commissioners**

Blv. "Dëshmorët e Kombit", Nr. 6

Tirana

Albania

Case Number            **DC-TIR-1-35**

Assessee                **Gerd HOXHA**

### **RECOMMENDATION TO FILE AN APPEAL**

according to

the Constitution of the Republic of Albania, Annex 'Transitional Qualification Assessment',  
Article B, paragraph 3, letter c and Article 65, paragraph 2 of the Law no. 84/2016 "On the  
transitional re-evaluation of judges and prosecutors in the Republic of Albania" (Vetting Law)



## **1. Introduction**

The assessee Gerd Hoxha holds the office of Judge at Tirana Court of First Instance. He is assessed *ex officio* pursuant to Article 179/b, paragraph 3 of the Constitution of the Republic of Albania.

The re-evaluation process was carried out based on three criteria: assets, background, and proficiency. Upon administering the reports of the auxiliary bodies, thorough investigation of the case, administering evidence obtained through the investigation process and submitted by the assessee, the Independent Qualification Commission (hereafter: IQC) Adjudication Panel closed the investigation on 27 April 2021 and notified the assessee the findings with requests for explanations.

The assessee was notified of the hearing, which took place on 01 June 2021. Following the deliberation as per Article 55, paragraph 5 Vetting Law, the Adjudication Panel decided to confirm the assessee in duty pursuant to Article 59, paragraph 4, Vetting Law, and the decision was announced publicly on 03 June 2021.

The International Observers, having reviewed the case file and the results of the public hearing, deems that a review of the case by the Special Appeal Chamber (hereinafter: AC) is necessary for the reasons explained hereinafter.

The International Observers (IOs) recommend to the Public Commissioners (PCs) to file an appeal against the decision no. 393 dated 03 June 2021 of the Independent Qualification Commission (IQC) with a majority decision in the case of the assessee Gerd Hoxha, DC-TIR-1-35 case number, by which he was confirmed in duty.

## **2. Grounds for the recommendation of appeal of the asset pillar**

In this recommendation IOs refer to the assessee Gerd Hoxha (G.H.) and his former wife \*\* \*\* (also an assessee) as related persons to each other, as per Article 3.13 of the Vetting Law, because in the moment of the vetting declaration submission, both assesses were married with each other (2012-2019) and they co-owned all their declared assets. Even though they were divorced in 2019, this should not affect the vetting process and the assessment conducted by the vetting authorities.

### **I. Apartment in Tirana 125 m2 co-owned with the related person \*\* \*\***

Apartment in Tirana 125 m2 co-owned with the related person (former wife) \*\* \*\* purchased for 6 500 000 ALL. An agreement for the promise to sale (off-plan) was signed on 02 February 2011 between the assessee and \*\* \*\*, as buyers and Mrs. \*\* \*\* and Mr. \*\* \*\* former sister-in-law of the assessee and her husband, as sellers.

This asset was reevaluated on \*\* December 2011, just few months after the off-plan agreement, to the amount of 23 750 000 ALL. This re-evaluation had repercussions in relation to the taxes paid by the seller. The sale agreement was signed on \*\* October 2012.

According to the vetting declaration of the assessee, one source of the purchase of this asset was a donation by his former sister-in-law (the half owned by the related person to the assessee, \*\* \*\*). The assessee G. H. paid for his half of 6 500 000 ALL, with the following financial sources:

- a. 1 500 000 ALL from his savings.

- b. 5 000 000 ALL from a soft loan received by assessee on 09 June 2011 with the related person \*\*\* as a guarantor. The off-plan agreement of \*\* February 2011 was signed with the aim of taking the soft loan and this asset/apartment was placed as guarantee.

Below there is an analysis of the savings by assessee G.H. and his financial capacity to create the amount of 2 500 000 ALL declared as savings in the periodic declaration of 2003.

#### **The savings mentioned above in point a) of the assessee G. H.**

In 2003 G. H. declares savings to the amount of 2 500 000 ALL, as a source for this savings he declares his income from the Magistrates School and his work in the private sector as of 1995 and onwards as a waiter.

The assessee was shifted the burden of proof, in relation to the legitimacy of his income from his declared work from 1995 until 2000, to the amount of 1 273 804 ALL. During this time, the assessee was a full-time student of the Tirana Law Faculty. The assessee provided the IQC with notarial declarations from his former employers, who declared that the assessee had been employed by them as an unregistered employee in the service sector, mainly as a waiter. The assessee as well submitted documents from the Social Insurance Institute on two of his former employers. In these documents it is stated that the state authorities do not possess pay slips regarding the declared employers of the assessee from 1995 – 2000. Based on this, in his answers to the results of the investigation the assessee has claimed that, given the fact that the state authorities do not have information on his employment and taxes paid by him, he is in the position of objective impossibility as per Article 32.2 of the Vetting Law to provide documents on taxes being paid and as a result he is the position of objective impossibility to prove the legitimacy of the disputed income.

Based on the evidence collected during the administrative investigation, the IOs are of the opinion that the assessee is not in the legal position provided by the Article 32.2 of the Vetting Law. According to the notarial declarations of his former “employers” he was never registered with the state authorities as an employee. Therefore, taxes were never paid on the disputed income. Documents on taxes paid by him never existed and for this reason the Social Insurance Institute accurately states that they do not have information. As a result, the assessee cannot be in the position stated in the Article 32.2 of the Vetting Law, which foresees the objective impossibility.

Article D of the Constitution and the well-established case law of the Appeal Chamber, for an asset to be considered lawful, two conditions are to be met cumulatively: the income used for its creation or acquisition had to originate from a lawful activity and the income ought to have been subject to the payment of applicable taxes.

According to the unilateral notarial declarations mentioned above the required criteria to consider the savings – declared by the assessee G. H. in 2003 as lawful – are not met and as a result this income cannot be considered in the financial analysis.

#### **II. The loan from : \*\*\* . Bank Albania**

On \*\* April 2009,\*\* \*\* , related person to the assessee, took a loan of 25 000 euro from \*\*\* Bank with the aim to reconstruct and furnish the apartment of 125 m2 in Tirana, that they had planned to buy



from the sister-in-law of the assessee, \*\*\*<sup>1</sup>. The assessee G. H. was the guarantor of this loan agreement. This legal action qualifies \*\*\* as another related person to the assessee G. H., as of 2009 until their marriage in 2012.

On\*\* February 2011<sup>2</sup>, according to the bank statement, the sister-in-law of the assessee/other related person \*\*\* pays back the bank loan. The assessee in his vetting declaration stated that the amount of 25 000 euro was given to his wife<sup>3</sup> by her parents in order to pay back the bank loan.

According to the assessee the loan of 25 000 euro was received by his related person, \*\*\* from her parents (not paid back yet). The source of this loan is the retirement pensions of the parents of \*\*\* and a monthly allowance of 40 000 ALL, that the sister-in-law of the assessee, \*\*\* had given to her parents from 1995 and onwards. In the notarial declaration of the sister-in-law of the assessee \*\*\* and her husband, they have declared that they have given this monthly allowance to her parents *"in order to meet their average living needs and cover any other expenses that they may have had since 1995"*.

The monthly allowances were given to her parents by \*\*\* (sister-in-law of the assessee) with the aim of giving them the possibility to have an average style of life and by itself it is only logical that they would have spent this money during the years to have the lifestyle their daughter \*\*\* had aimed for them and not to have saved it. On the other hand, \*\*\* was supporting financially \*\*\* separately<sup>4</sup> so her parents should have felt secure about her financial situation so there was no need to save money for \*\*\*

IQC in their decision have analyzed the financial capacity of the sister-in-law to give the monthly allowances to her parents. It is the IOs view that the parents-in-law should be analyzed on their capacity to save and lend as well.

Therefore, the IOs are of the opinion that based on the notarial declaration of \*\*\* and her husband, the living expenses of the parents in law of the assessee should not be calculated in minimum as which was done by the IQC.

Furthermore, we would suggest that the amount of 25 000 euros seems to be not justified by the parents in law of the assessee and as such should not be considered in the financial analysis.

The IOs recommend that the income of the parents in law of the assessee should be fully investigated in the framework of the reevaluation process of the assessee G.H. for the reason that the assessee co-owned and used the apartment in Tirana, which is reconstructed and furnished with the loan received from the other related person, \*\*\*

### **III. Apartment in Vlora 128 m2 purchased for 55 452 euro on\*\*\*September 2016.**

According to the vetting declaration of the assessee, this apartment was purchased with his savings and those of his wife, without specifying the years in which these declared savings were created.

---

<sup>1</sup> The off-plan agreement between the assessee G. H., his related person \*\*\* and his sister-in-law for this asset was signed in 2011 and the sale agreement in 2012.

<sup>2</sup> The same day as the off-plan agreement.

<sup>3</sup> Related person \*\*\* , co-owned real-estate before marriage in 2012.

<sup>4</sup> Please refer to the 5 000 000 ALL sum declared by \*\*\* in her initial declaration as donations and financial assistance from the sister \*\*\* to the \*\*\*

Based on the reasoning above, the savings of the assessee from his work as a waiter during 1995 – 2000, appear not to be justified, because they do not meet the legal criteria set on the Article D of the Annex of the Constitution, since there is no proof of taxes being paid. Given the fact, that the assessee has not specified, which of his savings were used to purchase this asset, the savings from his work as a waiter should be excluded from the financial analysis.

#### IV. The vehicle Audi in the ownership of \*\*\*\* and use of G. H.

This vehicle was purchased by \*\*\*\* (father of the assessee G. H.) on \*\* April 2011 for 37 000 USD, furthermore customs and taxes were paid in the amount of 931 091 ALL. On \*\* June 2011 the vehicle was imported to Albania.

On \*\* July 2011 \*\*\*\* as the lender and G. H. as the borrower signed a notarial use agreement. In this use agreement is stated that *"the lender authorizes the use of the vehicle, which is in a good physical condition to the borrower. This use agreement is signed for an indeterminate time and the vehicle to be used within and outside the Republic of Albania. From this day and onward, the borrower is responsible legally for the vehicle and its physical condition."*

The use of this vehicle was declared by the assessee in his vetting declaration. This vehicle was later sold on \*\* July 2018 by \*\*\*\*

Based on the use agreement, signed between \*\*\*\* and G. H., the lender \*\*\*\* was qualified as another related person and the assessee was shifted the burden of proof, to prove the financial capacity of \*\*\*\* to purchase this asset. Based on the evidence submitted by the assessee, IQC conducted a financial analysis on the other related person\*\*\*\* In this financial analysis is included the income of his father \*\*\*\* his mother \*\*\*\*, his sister \*\*\*\*and the assessee.

The IOs are of the opinion, that income of the assessee should not be included in the financial analysis because of the following reasons:

- the assessee was subject of periodic declaration since 2003 onwards and he declared his cash savings in the following periodic declarations (which were declared to have been used to purchase the immovable assets he co-owns with his related person \*\*\*\*);
- he never declared to have had additional cash savings, which were used to purchase the vehicle.
- the assessee could not have contributed to purchase the vehicle, because the parents of the assessee, \*\*\*\* and \*\*\*\* declared<sup>5</sup> that all expenses of their children were covered by them. As declared, G. H. and his siblings could be in a position to save as much money possible to enable them to create savings for their future families.

The IOs are also of the opinion that the income of the sister of the assessee, \*\*\*\* should not be included in the financial analysis, as the parents of the assessee declared in the notarial declaration that they financially supported their children.

Just one week after the circulation permit of the vehicle was issued (on \*\* July 2011), \*\*\*\* signed a use agreement with the assessee G. H. to transfer the use of the car within and outside Albania to the assessee for an indefinite time. According to the notarial use agreement, from the day of the agreement the assessee

<sup>5</sup> In their notarial declaration of \*\* September 2020.



– as the borrower – shall bear all legal responsibilities of the car and shall be responsible for the physical maintenance of it.

Based on the above the IOs are of the opinion that the assessee was the de facto owner of car. From this presumption we conclude that this vehicle was a hidden asset of the assessee G. H. and used by his entire family.

#### V. The vehicle Citroen C4 purchased in year 2012.

The vehicle Citroen C4<sup>6</sup> was purchased by the assessee and the related person \*\* on \*\* August 2012, based on the contract with ' \*\*\* \*\*\* , for the price of 16 500 euro. The first lease equivalent to 54.5 % of the final value has been paid in the moment of signing the contract, while the following lease payments were paid afterwards on monthly basis.

According to the financial analysis of the IQC, the assessee – as identified in the IQC Results of Investigation – lacks financial capacity to purchase the car. The assessee explained that “[...] the non-disclosure of the cash balance increase by the amount of ALL 1,200,000 for the year 2011[...]” is the reason of the lack of financial capacity in the year 2012.

The IOs are of the opinion that, this explanation is not to be sufficient, and by that the assessee lacks the financial capacity to buy this vehicle in the year 2012.

#### 3. Grounds for the recommendation of appeal of the proficiency pillar

The IOs are of the opinion that the reevaluation should include the proficiency pillar, especially the findings and the opinion of the IO assigned to the case, which are reflected in the IQC decision.

#### 4. General conclusion

The International Observers recommend the Public Commissioners to file an appeal against the Independent Qualification Commission decision confirming the assessee in office.

The appeal would enable the Special Appeal Chamber to conduct a thorough investigation of the assessee, his related and other related persons, their financial analysis, their assets, and private interests as well as the proficiency evaluation of the assessee, which would ensure that indeed he has the public trust, the restoring of which is the main aim of the vetting process and the institutions implementing it.



International Observer

International Observer

International Observer

<sup>6</sup> with the car plate AA: \*\*\*